



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Nr./Br.

Data/Datum.

PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.982/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Goran Milenkovic – Anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik N.SH “Spinp Agency”- Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të autoritetit kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Implementimin e Platformës digjitale E-Shkollori” me nr. të prokurimit: 616-20-6478-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Prishtinë”, më datën: 18.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik N.SH “Spinp Agency”-Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të Autoritetit Kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Implementimin e Platformës digjitale E-Shkollori” me nr. të prokurimit: 616-20-6478-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Prishtinë”.

II. VËRTETOHET, njoftimi për anulim i AK-së për aktivitetin e prokurimit me titull: “Implementimin e Platformës digjitale E-Shkollori” me nr. të prokurimit: 616-20-6478-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Prishtinë”.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues N.SH “Spinp Agency”-Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues N.SH "Spin Agency"-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 20.11.2020 me nr. 982/20, kundër njoftimit për anulim të Autoritetit Kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Implementimin e Platformës digjitale E-Shkollori" me nr. të prokurimit: 616-20-6478-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "KK-Prishtinë", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 59, 62 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 44 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 23.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues-teknik të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues-teknik i prokurimit në raportin e dt: 06.12.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore te OE ankues

Eksperti shqyrtues teknik pas shqyrtimit në detaje të pretendimit të OE ankues, analizimit të DT, NJK, specifikacionit teknik, përshkrimi i çmimeve vendimeve të AK, kërkesave për sqarime dhe fakteve të kësaj ekspertize mendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 – mbi hartimin e specifikacioneve teknike. Specifikacionet teknike në aneksin 1 Specifikacioni teknik i detyrueshëm, është specifikacion teknik jo profesional dhe me shumë mangësi profesionale të cilat vërehen lehtë. Për një sistem apo platforme e-shkollori AK ka vendosur si specifikacion teknik vetëm dy faqe, ku dhe ato dy faqe nuk precizojnë qare kërkesat të cilat duhet të vendosen. AK dhe njësia e kërkesës duhet të hartoj specifikacion profesional dhe bazuar në kërkesën të cilat janë në interes të zbatimit të platformave të tilla, dhe jo të vendos kritere apo kërkesa të cilat favorizojnë një platforme apo një tjetër.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1 : Nenin 1 dhe Nenin 6

Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimin ankimor të OE: N.SH "SPINP Agency"- Prishtinë, mbi shkeljet nga AK sqaron se AK nuk ka shpallur asnjë OE fitues andaj nuk mund të thuhet se AK me veprimet

dhe vendimet e tij ka vepruar ne kundërshtim me Nenin 1 dhe Nenin 6. AK ne këtë rast nuk ka dëmtuar buxhetin. Andaj ky pretendim është i pabazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2 : Nenin 59 dhe Nenin 62

Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimin ankimor të N.SH "SPINP Agency"- Prishtinë, mbi shkeljet nga AK sqaron se AK nuk ka kryer vlerësim profesional dhe nuk ka kryer vlerësim konform kërkesave te cilat kane qene ne njoftimin për kontrate dhe dosjen e tenderit. AK KK Prishtine ka anuluar aktivitetin ne kundërshtim me nenin 62. AK ka nxjerr vendimin për anulim te aktivitetit te prokurimit duke pare te gjitha probleme teknike dhe profesionale te cilat nuk janë parapare ne kohen e inicimit te aktivitetit te prokurimit. Andaj ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1 : Nenin 72

Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimin ankimor të N.SH "SPINP Agency"- Prishtinë, mbi shkeljet nga AK sqaron se AK nuk ka mundur te kërkoj sqarime dhe informacione shtese për kërkesa te cilat nuk janë planifikuar ne kohen e inicimit te aktivitetit te prokurimit. AK ka mundur ta shfrytëzoj nenin 72 mbi kërkesën për informacione shtese dhe te kërkoj nga AK për ato te cilat nuk kane mundur te planifikohen ne kohen e inicimit. Andaj ky pretendim është i pabazuar. Eksperti shqyrtues teknik sqaron se Specifikacioni Teknik nuk është profesional, dhe i njëjti nuk është dokumentuar, shkruar i plote për te ofruar një platforme e cila do te ofroj shërbimet e tilla. Te ri tenderohet ky aktivitet i prokurimit, për te njëjtin te hartohen specifikacione teknike te cilat i plotësojnë në perpikmëri kërkesat nga njësia kërkuese dhe te mos ketë mangësi profesionale specifikacioni teknik.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet dhe të gjeturat në këtë ekspertizë, eksperti shqyrtues teknik i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht të bazuar , dhe të mbetet ne fuqi vendimi i AK – KK Prishtine mbi anulimin e aktivitetit te prokurimit.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 09.12.2020 me raportin e ekspertizës.

Operatori Ekonomik: N.SH"Spinp Agency" - Prishtinë, me datë: 09.12.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk-pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 18.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues/teknik të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se pas shqyrtimit në detaje të pretendimit të OE ankues, analizimit të dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë, specifikacionit teknik, përshkrimit të çmimeve, vendimeve të AK, kërkesave për sqarime dhe fakteve tjera, konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 mbi hartimin e specifikacioneve teknike. Specifikacionet teknike në aneksin 1 Specifikacioni teknik i detyrueshëm, është specifikacion teknik jo profesional dhe me shumë mangësi profesionale të cilat vërehen lehtë. Për një sistem apo platformë e-shkollori, AK ka vendosur si specifikacion teknik vetëm dy faqe, ku dhe ato dy faqe nuk precizojnë qartë kërkesat të cilat duhet të vendosen. AK dhe njësjia e kërkesës duhet të hartoj specifikacion profesional dhe bazuar në kërkesën të cilat janë në interes të zbatimit të platformave të tilla, dhe jo të vendos kritere apo kërkesa të cilat favorizojnë një platformë apo një tjetër.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues N.SH "Spin Agency"-Prishtinë mbi shkeljet nga AK, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se AK nuk ka shpallur asnjë OE fitues andaj nuk mund të thuhet se AK me veprimet dhe vendimet e tij ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 dhe nenin 6. AK në këtë rast nuk ka dëmtuar buxhetin. Andaj, ky pretendim është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të N.SH "SPINP Agency"- Prishtinë, mbi shkeljet nga AK, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se AK nuk ka kryer vlerësim profesional dhe nuk ka kryer vlerësim konform kërkesave të cilat kanë qenë në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. AK e ka anuluar aktivitetin në kundërshtim me nenin 62. AK ka nxjerr vendimin për anulim të aktivitetit të prokurimit duke parë të gjitha probleme teknike dhe profesionale të cilat nuk janë paraparë në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit. Andaj, ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të N.SH "SPINP Agency"- Prishtinë mbi shkeljet nga AK, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK nuk ka mundur të kërkoj sqarime dhe informacione shtesë për kërkesa të cilat nuk janë planifikuar në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit. AK ka mundur ta

shfrytëzohet nën 72 mbi kërkesën për informacione shtesë dhe të kërkojë nga AK për ato të cilat nuk kanë mundur të planifikohen në kohën e inicimit. Andaj, ky pretendim është i pa bazuar. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se Specifikacioni Teknik nuk është profesional, dhe i njëjti nuk është dokumentuar, shkruar i plotë për të ofruar një platformë e cila do të ofroj shërbimet e tilla.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues/teknik, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues me rastin e përpilimit të specifikimeve teknike nuk është bërë përcaktimi i duhur i nevojave që duhet përbushur për këtë aktivitet të prokurimit, duke devijuar nga qëllimi për shkak të devijimit të specifikimeve teknike dhe nga nevojat e autoritetit kontraktues. Andaj, obligohet AK që me rastin e ritenderimit të hartoj specifikime teknike të cilat i plotësojnë në përpikëri kërkesat nga njësitë kërkuese dhe të mos ketë mangësi profesionale në specifikime teknike.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Blerim DINA



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "KK-Prishtinë";
- 1x1 OE N.SH"Spin Agency"-Prishtinë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.